

**Albsig sh.a.**

**Pasqyrat financiare individuale  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**  
**së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur**

## **Përbajtja**

<b>Raporti i Audituesit te Pavarur</b>	<b>i-iii</b>
<b>Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar</b>	<b>1.</b>
<b>Pasqyra Individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse</b>	<b>2.</b>
<b>Pasqyra Individuale e ndryshimeve në kapital</b>	<b>3.</b>
<b>Pasqyra Individuale e fluksit të parasë</b>	<b>4.</b>
<b>Shënimë ne pasqyrat financiare individuale</b>	<b>5.</b>
<b>Skedulet suplementare.....</b>	<b>i-iv</b>

## RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për Drejtimin e Shoqërisë Albsig sh.a.

### Opioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Albsig sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për opinionin

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkuar në mënyre më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikes për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikes për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikes të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA) qe janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike ne përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit qe kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhëne një baze për opinionin tonë.

### Informacioni tjetër

Drejtimi është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin qe jepet ne Raportin Vjetor, të përgatitur nga drejtimi në përputhje Ligjin 52 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve", dhe nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe reportin tone të auditimit mbi to. Raporti ynë mbi këto pasqyra financiare nuk mbulon informacionin tjetër dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj tjetër konkluzioni qe jep sigurie mbi to.

Ne lidhje me auditimin tone të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër dhe, gjatë këtij procesi, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është në mënyre materiale jo konsistent me pasqyrat financiare ose me njohuritë e përfituar gjatë auditimit ose nëse në dukje është në mënyre materiale i gabuar.

Nëse, bazuar në punën qe ne kemi kryer, ne arrijmë në përfundimin se ka gabime material në informacionin tjetër, atëherë ne duhet ta raportojmë këtë fakt. Në datën e lëshimit të këtij rapporti, Shoqëria akoma nuk e ka publikuar informacionin tjetër. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me të.

### Përgjegjësitë e Drejtitit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontolle të brendshme qe drejtimi i gjykon të nevojshme për të bere të mundur

përgatitjen e pasqyrave financiare qe nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet qe kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvèç se në rastin kur drejtimi synon ta likidoje Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përvèç sa me sipër.

### **Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë qe të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi qe përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci qe një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikoje gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra se bashku, pritet që në mënyre të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjese e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi qe është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një baze për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është me i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshije marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm qe ka të beje me auditimin me qellim qe të përcaktojmë procedurat e auditimit qe janë të përshtatshme sipas rrëthanave, por jo për qëllime të shprehjes se një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyesh mérinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marre, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhe dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin qe ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në reportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marre deri në datën e rapportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë qe Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshire informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në lidhje me to në një mënyre qe arrin paraqitjen e drejtë.


Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjera, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshire ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që në mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore - kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"), mbi Marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktivet në Mbulim të Rezervave Teknike**

Në bazë të kërkesave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ne kemi lexuar skedulet plotësuese shoqëruese të aftësisë paguese dhe aktivet që mbulojnë detyrimet e sigurimeve. ("skedulet plotësuese"). Këto skedule plotësuese të përgatitura nga drejtimi janë pjesë shoqëruese e pasqyrave financiare individuale. Informacioni finansiar historik, i paraqitur ne skedulet plotësuese të përgatitur nga drejtimi, është konsistent, ne të gjitha aspektet materiale, me informacionin vjetor finansiar të shpalosur ne pasqyrat financiare individuale shoqëruese të Shoqërisë me 31 dhjetor 2021, të përgatitur në përputhje me SNRF. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e skeduleve plotësuese, në përputhje me ligjin nr. 52 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve".

Nexia AL shpk  
Auditues Ligjor  
Orjana Kalaja

Tirana, Albania  
31 mars 2022



Shënime	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
<b>Aktivet</b>		
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	6	68,691,416
Depozita me afat	7	1,409,924,784
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8	276,471,659
Aktive të lidhura me risigurimin	9	103,076,076
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	100,324,914
Aktive të tjera	11	112,167,294
Tatim fitim i arketueshem	29	-
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	814,547,024
Aktive afatgjata materiale	13	1,645,619,115
Aktive afatgjata jomateriale	14	3,261,481
Aksione në shoqëri të lidhura	15	432,254,000
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>4,966,337,763</b>
<b>Kapitali</b>		
Kapitali aksionar	16	879,460,000
Fitime të mbartura		710,420,127
Fitimi i ushtrimit		239,517,914
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,829,398,041</b>
<b>Detyrimet</b>		
Rezerva teknike për dëmet	17	733,379,388
Rezervat e primit të paftuar	18	2,088,669,138
Llogari te pagueshme per risigurimet	19	35,474,884
Detyrime ndaj paleve te lidhura	20	19,957,356
Tatim fitim i pagueshëm	29	8,391,046
Detyrime të tjera	21	251,067,910
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>3,136,939,722</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>4,966,337,763</b>

Shënimet nga faqja 5 në 40 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

**Albsig sh.a**

**Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që mbyllt më 31 dhjetor 2021**

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimë	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Prime të shkruara bruto	22	3,328,073,892	2,687,242,421
Ndryshimi në rezervën e primit të paftuar	18	<u>(586,745,693)</u>	<u>(348,131,728)</u>
<b>Të ardhura bruto nga primet e sigurimit</b>		<b>2,741,328,199</b>	<b>2,339,110,693</b>
Prime të ceduara në risigurim	23	(152,508,467)	(124,991,108)
Ndryshimi në rezervën e primit paftuar të risiguruesit	9	<u>14,448,673</u>	<u>(3,946,616)</u>
<b>Të ardhura neto nga primet e sigurimit</b>		<b>2,603,268,405</b>	<b>2,210,172,969</b>
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	24	26,828,599	5,102,178
Të ardhura nga intereseti	25	11,251,930	13,348,880
Të ardhura të tjera		<u>8,260,192</u>	<u>12,215,365</u>
<b>Të ardhura të tjera</b>		<b>46,340,721</b>	<b>30,666,423</b>
<b>Të ardhurat neto</b>		<b>2,649,609,126</b>	<b>2,240,839,392</b>
Dëme të paguara të sigurimit	17	(873,105,465)	(1,750,951,399)
Dëme të paguara nga risiguruesi	17	171,732,403	1,101,534,420
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të sigurimit	17	293,436,443	538,802,863
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risigurimit	9	<u>(254,575,719)</u>	<u>(647,649,151)</u>
<b>Dëme të sigurimit neto</b>		<b>(662,512,338)</b>	<b>(758,263,267)</b>
Kostot e marjes në sigurim	26	(920,867,500)	(738,954,705)
Shpenzimet administrative	27	(633,234,662)	(479,627,644)
Shpenzime të tjera të sigurimit	28	<u>(130,413,666)</u>	<u>(85,647,354)</u>
Shpenzime financiare neto		<u>(10,738,749)</u>	<u>16,280,675</u>
<b>Total shpenzime operative</b>		<b>(1,695,254,577)</b>	<b>(1,287,949,028)</b>
Humbje nga shitja e aktiveve materiale afatgjata	13	<u>(4,709,548)</u>	<u>(1,476,953)</u>
<b>Fitimi i vitit para tatimit</b>		<b>287,132,663</b>	<b>193,150,144</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	29	(47,614,749)	(33,590,559)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		<u>-</u>	<u>-</u>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>(47,614,749)</b>	<b>(33,590,559)</b>
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>239,517,914</b>	<b>159,559,585</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>239,517,914</b>	<b>159,559,585</b>

Shënimet nga faqja 5 në 40 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

**Albsig sh.a**

**Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital më 31 dhjetor 2021**

(Vlerat në Lek, përvetë nëse shprehëndryshtës)

	Kapitali i akcionar	Fitimi i mbartur	Fitimi i vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2020</b>	<b>879,460,000</b>	<b>398,039,952</b>		<b>152,820,590</b>
Fitimi i vitit dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse				
Transferim në fitime të mbartura	-	-	159,559,585	159,559,585
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020</b>	<b>879,460,000</b>	<b>550,860,542</b>		<b>(152,820,590)</b>
Fitimi i vitit dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse				
Transferim në fitime të mbartura	-	-	159,559,585	159,559,585
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021</b>	<b>879,460,000</b>	<b>710,420,127</b>		<b>239,517,914</b>
Shënimet nga faqja 5 në 40 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.				
Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 25 mars 2022 dhe janë firmosur nga:				

**Z. Muhamməd Bardhoci**  
Drejtor i Përgjithshëm

*Z. Irfan Lami*  
Drejtor i Financës

Albsig sh.a

**Pasqyra individuale e flukseve të parasë për vitin që mbyllt më 31 dhjetor 2021**

(Vlerat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)

Shënim i	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitimi neto para tatimit</b>	<b>287,132,663</b>	<b>193,150,144</b>
Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	73,585,199	61,117,824
Zhvleresim i te arketushmeve	10,304,689	10,606,810
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve ne kapitalin qarkullues</b>	<b>371,022,551</b>	<b>264,874,778</b>
<b>Ndryshimet në</b>		
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8	5,394,663 (130,013,776)
Aktive të lidhura me risigurimin	9	240,127,046 651,595,767
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	8,365,980 21,605,736
Aktive të tjera	11	(39,422,854) 3,408,724
Kosto të shtyra të marjes në sigurim	12	(290,706,043) (182,538,660)
Rezerva teknike per demet	17	(293,436,443) (538,802,863)
Rezervat e primit te paftuar	18	586,745,693 348,131,728
Llogari te pagueshme per risigurimet	19	977,626 (14,502,371)
Detyrime ndaj paleve te lidhura	20	(15,572,240) 17,389,643
Tatim fitim i pagueshem	29	13,374,915 (19,101,054)
Detyrime te tjera	21	(30,298,146) 31,929,622
<b>Fluksi monetar gjeneruar nga veprimitaria operative</b>	<b>556,572,748</b>	<b>453,977,274</b>
Tatimi fitimi i paguar	29	(47,614,749) (33,590,559)
<b>Fluksi monetar neto i gjeneruar nga veprimitaria operative</b>	<b>(47,614,749)</b>	<b>(33,590,559)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese:</b>		
Blerje të aktiveve afat-gjata materiale	13	(379,290,776) (299,780,139)
Blerje të aktiveve afat-gjata jo materiale	14	937,418 (1,334,459)
Renja\Rritja në depozita me afat	7	(122,555,279) (92,888,485)
Investime në shoqëri të kontrolluara	15	- (30,254,000)
<b>Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimitaria investuese</b>	<b>(500,908,637)</b>	<b>(424,257,083)</b>
<b>Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë bankë</b>	<b>8,049,362</b>	<b>(3,870,372)</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	6	60,642,054 64,512,426
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit</b>	<b>68,691,416</b>	<b>60,642,054</b>

Shënimet nga faqja 5 në 40 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

## **1. Përshkrim i përgjithshëm**

Albsig sh.a. (tani e tutje do i referohemi si “Shoqëria”) është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me seli në Tiranë në adresën Rruga e Barrikadave, (Pallatet 9 Katëshe) Nr.1001. Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtarë" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 janar 2004, dhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numer identifikimi K42108801C.

Shoqëria operon sipas liçensës të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si “AMF”), për të ushtruar veprimtari sigurimi sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 qershor 2004, ndërsa liçensa që specifikon klasat e aktiviteteve është lëshuar më datë 10 shtator 2004 nga AMF. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhëni e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pasurinë, shëndetin, dhe produkte të tjera të sigurimit jo-jetë. Shoqëria ka 25 degë gjithësej në qytetet: Tiranë, Durrës, Dibër, Sarandë, Shkodër, Fier, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Gjirokastër, Berat, Kavajë, Lushnje, Pogradec.

Më 31 dhjetor 2021, Shoqëria ka patur mesatarisht 243 punonjës dhe drejtues (më 31 dhjetor 2020: 234).

Anëtaret e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë gjatë vitit 2021 deri në nënshkrimin e këtyre pasqyrave financiare individuale janë:

- Shefqtet Kastrati - Kryetar
- Ilda Mucmataj - Anëtare
- Arben Breshani - Anëtar

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka themeluar shoqerinë Albsig Jetë sha me aktivitetet në Shqipëri për produktet e jetës. Shoqëria zotëron 100% të aksioneve. Albsig Jetë sha operon sipas liçensës nr.13 të lëshuar nga AMF, për të ushtruar veprimtari sigurimi jete sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jetës është marrë më datë 13 shtator 2019.

## **2. Bazat e përgatitjes**

### **2.1. Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Pasqyrat financiare u aprovuan nga drejtimi i Shoqërisë Albsig sha, me 15 mars 2022, dhe u autorizuan per aprovim nga Keshilli Mbikqyres i saj.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### **2.3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit**

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësimë dhe supozime të cilat ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësimë. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe në periudha të ardhshme që rishikimi ndikon.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjera, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshëm dhe relevant për rrethanat aktuale.

## 2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

### 2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit (vazhdimi)

Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

#### Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit

Për kontratat e sigurimit të jo-jetës, vlerësimet bëhen si për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të raportuara në deklaratën e datës së gjendjes financiare dhe për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të ndodhura por jo të raportuara ende në Deklaratën e datës së pozicionit financier ("IBNR"). Kostoja përfundimtare e kërkesave të papaguara është vlerësuar duke përdorur një gamë të kërkesave të teknikave standarde të projektimit.

Supozimi kryesor në themel per këto teknika është se për një kompani pretendimet e kaluara si përvojë zhvillimi mund të përdoren për projektin e zhvillimit të kërkesave të ardhshme dhe kostot përfundimtare. Si tilla, këto metoda nxjerrin zhvillimin e paguar dhe humbjet e shkaktuara, shpenzimet mesatare për kërkesë dhe numrat e kërkesave të bazuar në zhvillimin e vërejtur vitet e mëparshme dhe raportet per humbje që priten.

Zhvillimi historik dhe pretendimet historike është analizuar kryesisht nga vitet e aksidentit, por mund edhe të analizohen më tej nga zona gjeografike, si dhe nga linja të rëndësishme të biznesit dhe llojet e kërkesave.

Gjyki cilësor shtesë është përdorur për të vlerësuar shkallën në të cilën tendencat e kaluara nuk mund të zbatohen në të ardhmen, në mënyrë që të arrijë në koston e vlerësuar përfundimtare të kërkesave që paraqesin rezultatin e mundshëm nga rangun e rezultateve të mundshme, duke marrë parasysh të gjitha pasigurive të përfshira.

#### Humbja nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve

Shoqëria rishikon llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera për të vlerësuar zhvlerësimin në baza vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme para rënies që mund të jetë identifikuar me një debitor individuale në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të debitorit që lidhen me mungesat në aktivet në grup. Menaxhimi i shfrytëzon vlerësimet bazuar në përvojën historike të humbjeve për aktivet me karakteristika të rezikut të kredisë dhe evidencia objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofolin kur caktimin flukset e ardhshme të parasë.

#### Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësise

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare individuale. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në Shoqëri. Ndërsa masat kufizuese kanë filluar te lethesohen, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, dhe fitimi mund të ndikohen.

Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare individuale, Shoqëria po operon, vazhdon të përbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsyе vazhdon të zbatojë parimin e vijimësise në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale.

### **3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**

#### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar që është monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë dhe të gjitha vlerat janë te shprehura në Lek përvèç se kur është shprehur ndryshe. Monedha funksionale eshte monedha e ambientit primar ekonomik ne te cilin Shoqeria vepron. Nese treguesit e ambientit primar ekonomik përzihen, atëherë drejtimi përdor gjykimin e tij per te përcaktuar monedhën funksionale qe paraqet ne mënyrën me te vertete efektet ekonomike te transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve ne te cilat ndodhin. Investimet dhe veprimet e Shoqerise kryhen kryesisht ne Lek. Per rrjedhoje drejtimi ka përcaktuar Lekun si monedhën funksionale te Shoqerise.

#### **2.5. Parimi i vijimësisë**

Kufizimet per shkak te Pandemise Covid-19, kane ndryshuar përgjatë periudhes ne varësi te përhapjes se virusit ne Shqiperi. Akoma ka pasiguri te rëndësishme mbi efektet qe këto kufizime do kenë mbi fitueshmerine e Shoqerise ne periudhat e ardhshme.

Ne datën e përgatitjes se këtyre pasqyrave financiare, eshte e veshtire te vlerësosh, kufizimet e mundshme qe mund te implementohen ne Shqiperi, dhe si rrjedhoje, kjo e ben shume te veshtire përgatitjen e disa skenarëve te mundshëm per te matur impaktin mbi operacionet e Shoqerise ne periudhat e ardhshme.

Megjithese ekzistojne ende pasiguri te rëndësishme mbi faktin se si pandemia do të ndikojë në biznesin e Shoqerise në periudhat e ardhshme, drejtimi i saj beson se ka burime te mjafthueshme.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, pasiveve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkohen nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

Drejtimi i Shoqerise beson se ka aktive të mjafthueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit në kushtet aktuale.

### **3. Politika kontabël te rëndësishme**

Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar në përputhje me të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar nga Shoqëria.

*Standardet e reja dhe ato te ndryshuara efektive per periudhat vjetore duke filluar me ose pas dates*

*1 Janar 2021 dhe qe nuk kane ndonje efekt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise:*

- COVID-19- Koncesionet e Lidhura me Qirane (Perditesime te SNRF 16), data efektive 1 qershor 2020;
- Reforma e Normës së Interesit Referuese – Faza 2 (Perditesime te SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16), data efektive 1 Janar 2021;
- COVID-19- Koncesionet e Lidhura me Qirane pertej 30 Qershorit 2021 (Perditesime te SNRF 16), data efektive 1 Prill 2021;

*Standardet e reja qe mund te adoptohen me heret:*

- Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkrutra dhe afatgjata (Perditesime te SNK 1), data efektive 1 Janar 2022;
- Permiresime Vjetore ne SNRF 2018–2020, data efektive 1 Janar 2022;
- Aktivet afatgjata materiale: Shitet perpara perdonimit (Perditesime te SNK 16), data efektive 1 Janar 2022;
- Referanca ne Kuadrin Konceptual (Perditesime te SNRF 3), data ekeftive 1 Janar 2022;
- Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkrutra dhe afatgjata (Perditesime te SNK 1), data efektive 1 Janar 2023;
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve dhe perditesimet ne SNRF 17, data efektive 1 Janar 2023;
- Shenimet shpjeguese te politikave kontabel (Perditesimet ne SNK 1 dhe shenimi praktik 2 ne SNRF), data efektive 1 Janar 2023;
- Perkufizimi i vleresimeve kontabel (Perditesime te SNK 8), data efektive 1 Janar 2023;
- Tatimi i shtyre qe lidhet me Aktivet dhe Detyrimet qe vijne si pasoje e një Transaksiuni te Vetem (Perditesime te SNK 12), data efektive 1 Janar 2023;

**3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)****Standardet e reja te gatshme per adoptim opsional / data efektive eshte shtyre pafundesisht**

- Shitia ose Kontributi ne asete ndermjet nje investitori dhe shoqerise se asocuar te tij ose shoqerise se perbashket (Perditesime ne SNRF 10 dhe SNK 28)

**a) Filialet dhe konsolidimi**

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga shoqëria. Kontrolli ekziston kur shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose indirekt, që të qeverisë politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të nmarrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Shoqëria Mëmë Albsig sha, përgatit pasqyra financiare individuale dhe të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare individuale kontabilizohen me kosto. Më shumë detaje mbi investimet në filiale janë dhënë në Shënimin 15.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera e mbetur kontabël e tij mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse shuma e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës se tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël neto reduktohet në shumën e rikuperueshme.

Vlera kontabël e një investimi çregjistrohet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit nga shitjet dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjtë gjë vlen edhe nëse nxjerra jashtë përdorimit rezulton në kalimin nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose në pjesëmarrje të matur me kosto.

**b) Transaksione në monedhe të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet jo- monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivlerësohen në fund viti dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) pervec, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u percaktua vlera e tyre e tregut. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit njihen në të ardhura ose humbje.

Kurset kryesore të konvertimit në Lek Shqipëtar për 1 njësi të monedhes së huaj në datën e raportimit janë si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
EURO	120.76	123.70
USD	106.54	100.84

**c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit dhe investimeve (detyrimet)**

Produktet e sigurimit të Shoqërisë klasifikohen fillimisht, për qëllime të kontabilitetit si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhën ose pushojnë së ekzistuari.

Kontratat nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguruese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financier. Rreziku financier është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhëshme në një ose më shumë nga norma interesit specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablate jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financier.

### 3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)

#### d) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (detyrimit)

##### i. Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në një mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituar), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes së vitit finanziar). Detyrimet e sigurimit (provizonet) paraqesin vlerësimë të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimin dhe gjykimeve.

##### ii. Primet

###### Prime të krijura nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit finanziar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma mund ti përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme.

Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetesve dhe nuk përfshijnë tatimet dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

###### Rezerva për primet e pafituar

Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet të fitohet në vitin finanziar pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale 1/365, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Primi i pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e nënshkruara të cilat prezatohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetesve dhe prjashtojnë tatimet dhe detyrimet doganore të bazuara tek primet. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim njihen më vete si aktive të shtyra.

Rezerva për primet e pafituar për Kartonin Jeshil, TPL, Kufitare llogaritet mbi më të madhen midis primit të sigurimit dhe rrezikut siç parashikohet në vendimim e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare i bazuara në ligjin nr. 10455, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe ne Ligjin nr. 9572 datë 03 Korrik 2006 “Mbi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” (ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 29.05.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”).

##### iii. Dëmet

###### Dëmet e ndodhura nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura përbëhen nga kostot e mbylljes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguar që lindin nga ngjarje të ndodhura gjatë vitit finanziar së bashku me rregullime të provigjonit të dëmeve të vitit të mëparshëm. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, dëmet e refuzuara gjithashtu njihen si pjesë e dëmeve të papaguara për një periudhë 2-vjecare. Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke provigjonaluar dëmet e ndodhura por ende të paraportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara të brendshme dhe të ngjashme, të tilla si ndryshimet e procedurave në trajtimin e dëmeve inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legislative dhe eksperiencat e mëparshme. Provigioni për dëmet e papaguara nuk skontohet. Rregullimet për provigionin e dëmeve të viteve të mëparshëm reflektohen në pasqyrat financiare individuale të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale.

**3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**d) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (detyrimit)**

**iii. Dëmet (vazhdim)**

Ndërkohë, drejtimi konsideron që rezerva bruto për dëmet dhe mbulimet e risigurimit të lidhura me to janë përcaktuar saktë mbi baza të informacionit aktual të mundshëm për to, detyrimi më i fundit mund të variojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve në vijimësi dhe mund të rezultojë në korrigjime të shumave të rezervuara. Korrigjimet e shumave të rezervave të dëmeve të vendosura në vitet paraardhës janë reflektuar në pasqyrat financiare individuale të periudhës tek të cilat janë bërë rishikimet.

Një pjesë e dëmeve janë në proces gjyqësor dhe për të cilat Shoqëria ka regjistruar detyrimin përkatës në bazë të vedimit me të fundit të gjykatës ose vlerësimeve të drejimit.

*Rezerva e dëmeve*

Rezerva përfaqëson vlerësimin e kostos përfundimtare të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes së dëmit, të cilat lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit. Detyrimet e papaguara dhe rregullimet e shpenzimeve të humbjes përbëhen nga vlerësimi për humbjet e raportuara dhe rezervat për humbjet e ndodhura e të paraportuara. Metoda e përdorur për të përcaktuar rezervën e dëmeve, është bazuar në rregullat statutore të mëposhtme të zbatueshme por është mbështetur gjithashtu nga vlerësimet aktuariale.

Rezervat e sigurimit (provizonet teknike të primeve dhe dëmeve bruto) më 31 dhjetor 2021, janë aprovuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendim 53 datë 30 mars 2022, sipas nenin 89, pika 9 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe nenit 14, pika 22 të Ligjit nr. 9572 datë 03 Korrik 2006 "Mbi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" i ndryshuar.

Në përputhje me Ligjin Shqiptar të Sigurimeve dhe direktivave të tjera të lidhura me të, rezerva për dëmet e raportuara por jo të paguara ("RBNS") përcaktohet duke u zbatuar në çdo rast individualisht ne përputhje me praktikat me te mira aktuariale. Rezerva llogaritet si vlera e cila pritet të shlyejë dëmin, si dhe vlerësimi irregullohet ndërsa informacioni i ri bëhet i disponueshme. Rezerva për dëmet e ndodhura por të paraportuara ("IBNR"), vlerësohet sipas metodës së trekëndëshave të dëmit për linjat e biznesit TPL, Karton Jeshil, KASKO, Kufitare, Aksidente, Shëndet në udhëtim dhe Zjarri dhe rreziqet shtesë ndërsa një metodologji e thjeshtë raportesh, bazuar në krahasimin e dëmeve të raportuara gjatë vitit por të ndodhura në vitin e kaluar, përdoret për linjat e tjera të biznesit sipas praktikave të lejuara lokale.

**iv. Risigurimi**

Shoqëria kryen risigurime në vijimësinë normale të veprimtarisë me qëllimin e kufizimit të humbjes së mundshme neto përmes diversifikimit të rreziqeve nga MTPL, Prona, Aksidente, Pergjegjesi, Karton Jeshil, Kasko.

Risigurimet regjistrohen bruto në Pasqyrën e pozicionit financiar. Aktivet e risigurimit përfshijnë shuma të arkëtueshme nga shoqëritë e sigurimit për humbje të paguara dhe të papaguara si dhe shpenzime për rregullimin e humbjes. Shoqëria llogarit primet e ceduara duke u bazuar në primet e shkruara bruto dhe me shpenzimet që lidhen në mënyre direkte me primet. Aktivet e risigurimit regjistrohen për primet e pafituarat të ceduara. Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit vlerësohen në një mënyrë të qëndrueshme me detyrimet për demet dhe me politiken e risigurimit.

**v. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve**

Në çdo datë raportimi Shoqëria kryen testimin për tu siguruar për mjaftueshmërinë e rezervave të dëmeve. Testimet kryesore që kryen janë: Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analiza e Zhvillimit të Provizioneve të Dëmeve.

Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit dhe individualisht në pjesën më të madhe të linjave të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet që përfshijnë edhe koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin.

**3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**d) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (detyrimit)**

**v. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve (vazhdim)**

Në kryerjen e kësaj analize shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të rrjedhjeve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i skonton këto flukse të parashikuara të parasë pasi shumica e dëmeve priten të paguhën brenda vitit.

Në vazhdim, Shoqëria kryen një analizë vjetore të zhvillimit të provigjonimit të dëmeve për vlerësimin e metodologjisë së provizionimit. Kjo analizë kryet mbi RBNS dhe IBNR në baza individuale dhe të kombinuara. Në rast se analiza shfaq mospërputhje të madhe, korrigimet e duhura bëhen në metodën e provizionimit. Nëse identifikohet një pamjaftueshmëri e rezervave, ajo do t'i ngarkohet menjëherë shpenzimeve duke krijuar një rezervë rishkuar nga humbjet që rezultojnë nga Testi i Mjaftueshmërisë së Rezervave.

**vi. Kosto e marrjes në sigurim**

Kostot e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që lindin nga lidhja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, si komisionet e blerjes dhe kosto e hartimit të dokumenteve të sigurimit, dhe një pjesë të shpenzimeve administrative të lidhura me procesin e shitjes dhe emetimit të policave.

Kostot e dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të dëmit dhe nuk përfshijnë shpenzime të brendshme të dëmit të cilat janë menduar të mos janë të rëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Shoqëria krijon një tolerancë për kostot e dëmeve me rezervat që lidhen me dëmet.

Marrja në sigurim paraqet kostot direkte të jashtme siç janë komisionet e agjentëve, pagat për agjent, kostot e botimeve dhe marketingut të lidhura në mënyrë të qartë me produktin specifik.

Kostot direkte të marrjes në sigurim prezantohen si kosto të shtyra bazuar në termat e policës në fuqi me një metodë në përputhje me përllogaritjen e rezervës së primit të paftuar. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim prezantohen si zë më vete në pasqyrën e pozicionit financiar. Referuar ndryshime të publikuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 250, datë 27 dhjetor 2016, në përputhje me Ligjin Nr. 127/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9975, Datë 28.7.2008, "Për Taksat Kombëtare", Neni 5, Shoqëritë Sigurimit ngarkohen me mbledhjen e taksës mbi primet e shkruara. Për qëllime të mbledhjes së taksës, këto shoqëri e evidentojnë atë veçmas nga primi."

Shoqëria ka evidentuar vecmas taksën nga primi, rrjedhimisht kosto e marrjes në sigurim dhe kostost e shtyra te marrjes në sigurim janë pasqyruar vecmas nga taksa.

**e) Instrumentet financiare**

*(i) Njohja*

Shoqëria fillimisht njeh investimet dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilës Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

*(ii) Cregjistrimi*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar nëse humbet kontrollin mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përsfimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivit finanziar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhën, anullohen ose maturohen.

*(iii) Netimi*

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga Standartet e Kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

**3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**e) Instrumentet financiare (vazhdim)**

*(iv) Matja me kosto të amortizuar*

Kosto e amortizuar e një aktivi finanziar është vlera me të cilën aktivi finanziar ose detyrimi finanziar është matur në njojhen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh ndonjë diferencë midis vlerës së njojur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

*(v) Matja me vlerë të drejtë*

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiare në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentet financiare të tjera vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tillë si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjera të ngashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregje aktive si dhe modele të tjera vlerësimi.

*(vi) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë*

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare individuale Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivet financiare pësojnë rënje në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit te mëparshëm të aktivit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup të aktiveve. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë, por që nuk është identifikuar ende. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohen të janë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen së bashku me aktive me karakteristika të ngashme (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënje në vlerë.

Si evidencë objektive për rënje në vlerë të mundshme të aktiveve në pasqyrat financiare individuale individuale mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

**f) Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to**

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

**g) Depozitat me afat**

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit finanziar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet midis tre dhe dy mësueshme të muaj klasifikohen si investime në depozita me afat.

**h) Letra me Vlerë**

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fiksë ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provisionin për rënien në vlerë.

**3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**h) Letra me Vlerë (vazhdim)**

Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje. Primet dhe skontimet në investimet e projektuara si të mbajtura deri në maturim amortizohen sistematikisht gjatë maturitetit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe rregistrohen si të ardhura nga interesi.

**i) Llogaritë e arkëtueshme sigurimi dhe të tjera**

Kreditë dhe të drejtat e tjera njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provisionin për zhvlerësim. Provizioni për zhvlerësimin e kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme krijohet kur ka një evidencë objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Të drejtat e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit që vijnë nga mbajtësit e policave të sigurimit gjithashu klasifikohen në këtë kategori dhe rishikohen për zhvlerësim si pjesë e rishikimit për zhvlerësim të kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme.

**j) Njohja e të ardhurave**

*i. Primet e shkruara bruto*

Primet e shkruara bruto janë njohur sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara për kontratat e sigurimit, policat e lëshuara gjatë vitit janë kredituar në të ardhura sipas realizimit proporcional duke u bazuar në termat e kontratës së sigurimit. Rezerva e primeve të pafituar përfaqëson pjesën e primeve të shkruara që lidhen me termat e mbulimit që nuk kanë skaduar.

*ii. Të ardhura nga interesit*

E ardhura nga interesi njihet në bazë të të drejtave të konstatuara mbi principalin pezull, dhe duke përdorur normën efektive të interesit.

*iii. Të ardhura nga tarifat dhe komisionet*

Të ardhurat nga komisioni dhe tarifat njihen me bazë rrjedhëse.

**k) Shpenzimet**

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat u sigurojnë punonjësve përsitime pensioni pas shkëputjes nga puna. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të përcaktuar kufirin e vendosur minimal për pensionet në vendet përkatëse sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqërisë për planin e pensionit paraqiten në pasqyrën përbledhëse individuale të të ardhurave kur ndodhin.

*i. Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

*ii. Përsitimet e punonjësve*

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore.

*iii. Leja vjetore e paguar*

Shoqëria njeh si detyrim shumën e pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar. Për vitin 2021 punonjësit e shoqërisë i kanë përfunduar lejet e tyre vjetore.

*iv. Pagesat e qirave operative*

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën përbledhëse individuale të të ardhurave në përpjesëtim me kohëzgjatjen e kontratës së qirasë.

**3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**k) Shpenzimet (vazhdim)**

**v. Pagesat e qirave financiare**

Pagesat e qirasë janë të ndarë midis pagesave financiare dhe uljes së detyrimit ndaj qirasë, për të arritur në një nivel konstant të interesit në tepricën e mbetur të detyrimit. Pagesat financiare janë njohur si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**l) Llogari të pagueshme të sigurimit dhe të tjera**

Llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe të tjera mbahen me kosto.

**m) Aktive të mbajtura për shitje**

Aktivet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje maten me vlerën më të ulët mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Një njësi ekonomike klasifikon një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) si të mbajtur për shitje nëse vlera e tij kontabël (neto) do të rifitohet parimi që njoftimjet një transaksi shitjeje në vend të përdorimit të vazhdueshëm. Nëse ky është rasti, aktiv (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) duhet të jetë i përshtatshëm për shitje të menjëherësme në kushtet e tij aktuale subjekt vetëm për kushtet që janë të përdorshme dhe të zakonshme për shitjet e aktiveve të tillë (ose grupeve të nxjerrë jashtë përdorimit) dhe shitja e tij duhet të jetë me probabiliteti të lartë për t'u realizuar brenda një viti.

**n) Prona, ambjenti dhe pajisjet**

*Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afat-gjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi përveç ndërtimeve në proces të cilat maten me vlerën e rivlerësuar. Kostoja historike përfshin shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e këtyre elementeve.

Kur pjesë të një aktivit kanë diferenca mbi jetëgjatësinë e dobishmërinë, ato njihen si aktive të ndara (komponentë te rëndësishëm) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shumat e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferençën në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin ‘Fitime/(humbje) të tjera’.

*Kostot e mëpasshme*

Kostot e mëpasshme përfshirët ne vlerën e aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë vetëm kur është e mundshme që përfitimet të ardhshme do te rrjedhin nga ky aktiv dhe kostoja mund te matet ne mënyre te besueshme. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar nuk njihet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit dhe humbjes se periudhës financiare në të cilën ato kryhen.

*Amortizimi*

Amortizimi për ndërtimesat dhe përmirësimet e infrastrukturës llogaritet duke përdorur metodën lineare ne përputhjen me jetën e dobishme ekonomike te aktivit ndërsa amortizimi për zërat e tjerë te aktiveve llogaritet duke përdorur metodën me vlerën e mbetur ne përputhje me jetën e dobishme ekonomike te aktivit. Toka dhe aktivet ne ndërtim nuk amortizohen.

### 3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)

#### n) Prona, ambjenti dhe pajisjet (vazhdim)

Amortizimi vjetor i aktiveve afatgjata materiale sipas jetëgjatësisë se dobishme të parashikuar për periudhën e mëparshme dhe aktuale paraqitet si më poshtë:

Kategoria	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Ndërtesa dhe përmirësime infrastrukture	5%	5%
Makineri dhe pajisje	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilje dhe orendi	20%	20%
Pajisje kompjuterike dhe programe	25%	25%

Vlera e mbetur, nëse nuk është e parëndësishme, duhet të rishikohet çdo vit. Përmirësimet teknike kapitalizohen dhe zhvlerësohen përgjatë afatit më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

#### o) Aktivet aftatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale qe janë të blera nga Shoqëria, të cilat kanë një jetë të dobishme të kufizuar, vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimet akumuluara. Norma e amortizimit është 25% bazuar në vlerën e mbetur të aktivit.

##### *Shpenzimet e mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale*

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse shpenzimi rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin me të cilin ka të bëjë shpenzimi. Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzime për emrin e mirë të gjeneruar nga Shoqëria apo markat, njihen në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

##### *Amortizimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave bazuar në vlerën e mbetur duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të patrupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivit. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë bilanci.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferençat përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

#### p) Tatimi

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqet shumën e tatimeve të pagueshme dhe të shtyra.

##### (i) *Tatim fitimi aktual*

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatushëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatushme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatushme ose të zbritshme.

##### (ii) *Tatimi i shtyrrë*

Tatimi i shtyrrë kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit kontabël dhe llogaritet si tatimi i pritur për tu paguar ose për tu arkëtar nga diferençat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi finansiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale.

**3. Politika kontabël te rëndësishme (vazhdim)**

**p) Tatimi (vazhdim)**

Shuma e tatimit të shtyrrë të lejuar bazohet në mënyrën e parashikuar të realizimit ose pagesës të shumave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat fiskale të miratuara ose që priten të miratohen me siguri në datën e raportimit.

*(iii) Detyrimet e shtyra tativore*

Detyrimet e shtyra tativore njihen për të gjitha diferençat e përkohshme dhe aktivet tativore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë përfitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferençat e përkohshme. Aktivet tativore të shtyra reduktohen kur nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tativore do të realizohen. Tatimi i shtyrrë llogaritet me normën e taksës që është parashikuar për tu zbatuar në periudhën kur detyrimi paguhet ose aktivi të realizohet dhe ngarkohet në pasqyrën përbledhëse individuale të të ardhurave, përvç kur është e lidhur me zërat e ngarkuar direkt në kapital. Në të tilla raste tatimi i shtyrrë është gjithashtu pjesë e kapitalit.

**q) Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga aksionare dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influence të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme të tretë vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm forma ligjore.

**r) Ngjarjet pas datës së raportimit**

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare individuale individuale. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

**s) Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare individuale individuale. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulet. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare individuale individuale por paraqiten në shënimet sqaruese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmoj në provigionin, një detyrim njihet në ditën e pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

**4. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësimet dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura bazohen në përvojën historike dhe në faktorë të tjera që besohet të jenë të arsyeshëm sipas rrëthanave dhe informacioneve në dispozicion në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime mbi kryerjen e vlerat e akëtëve dhe pasiveve që nuk janë të dukshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimet kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse ndryshimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

#### **4. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël (vazhdim)**

Gjykimet e bëra nga drejtimi në zbatimin e SNRF-ve që kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe vlerësimet me një rrezik të konsiderueshëm të përshtatjes materiale në vitin e ardhshëm janë diskutuar më poshtë.

##### *Humbja nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve*

Shoqëria rishikon llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera për të vlerësuar zhvlerësimin në baza vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregojnë se ka një rënje të matshme në flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme para rënies që mund të jetë identifikuar me një debitor individual në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të debitorit që lidhen me mungesat në aktivet në grup. Menaxhimi i shfrytëzon vlerësimet bazuar në përvojën historike të humbjeve për aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidenca objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofol kur cakton flukset e ardhshme të parasë.

##### *Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimin e vijimësisë*

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ka vazhduar përgjatë vitit 2021 dhe deri ne datën e përgatitjes se këtyre pasqyrave financiare, në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka ende pasiguri mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsyе vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **5. Administrimi i rreziqeve**

##### **a. Rreziku i sigurimit**

Shoqëria pranon rrezikun e sigurimit nga kontratave të sigurimit kur merr përsipër rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë subjekt direkt i humbjeve të ndodhura. Shoqëria është e eksposuar ndaj pasigurive si pasojë e kohës, frekuencës dhe pasojave të dëmeve nën këto kontrata.

Shoqëria menaxhon rrezikun e saj nëpërmjet strategjisë së nënshkrimeve dhe risigurimeve me një strukture domethënëse të menaxhimit të rrezikut. Çmimi bazohet në supozimet të cilat kanë parasysh tendencat dhe eksperiencën e mëparshme.

Eksposimet janë manaxhuar duke patur limite dhe kritere të dokumentuara nënshkrimesh. Risigurimi është blerë për të lehtësuar efektin e humbjeve të mundshme të shoqërisë nga gjërësitë individuale ose ngjarjet katastrofike dhe gjithashtu për të siguruar akses në rreziqe specifike dhe për të asistuar në kapitalin menaxhues. Politikat e risigurimit janë përcaktuar me risiguruesit e aprovuar sipas ndarjes proporcionale ose të tejkalimit të humbjeve.

Shoqëria shkruan fillimisht rreziqet e sigurimit të pasurisë, sigurimit financiar dhe sigurimit të automjeteve me një maturitet deri në 12 muaj. Reziqet kryesore vijnë si rezultat i fatkeqësive natyrore, ndryshimet klimaterike dhe katastrofa të tjera (p.sh, ngjarje me frekuencë të ulët).

**5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)**

**a. Rreziku i sigurimit (vazhdim)**

Një përqendrim i rrezikut gjithashtu mund të vijë gjithashtu nga një kontratë e vetme sigurimi e lëshuar tek një tip demografik i veçantë police-mbajtësi, së bashku me vendndodhjen gjeografike ose tek tipet e biznesit tregtar. Varieteti relativ i rezultatit lehtësohet nëse ka një portofol të gjerë të rreziqeve të njëjtë.

*Supozimet dhe ndjeshmëritë*

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit jo-jetë janë të komplikuara dhe subjekt i një numër variabash të cilat komplikojnë analizën e matshmërisë së ndjeshmërisë. Shoqëria përdor statistika domethënëse dhe teknika të specialistëve të sigurimeve bazuar në eksperiencën e zhvilluar nga dëmet e kaluara. Kjo përfshin tregues të tillë duke përfshirë, numri më i fundit i dëmeve dhe raporti i humbjeve të pritshme.

Shoqëria konsideron që detyrimi për dëmet jo-jetë të njoitura në pasqyrën individuale të pozicionit finanziar është i mjaftueshëm. Gjithsesi, eksperiencia aktuale mund të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Rezultati i analizës së ndjeshmërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 duke treguar ndikimin në fitimin para tatimit është dhënë më poshtë.

Për këtë analizë është marrë parasysh ndryshimi i një faktori të vetëm, me supozimin që faktorët e tjera janë të pandryshueshëm.

5% rritje në normën e humbjes të ndodhur gjatë vitit  
5% pakësim në normën e humbjes të ndodhur gjatë

<b>Ndikim</b>	<b>2021</b>		<b>2020</b>	
	<b>në Lek</b>		<b>në Lek</b>	
Humbje	(14,356,633)		(9,657,507)	
Fitim	14,356,633		9,657,507	

**Albsig sh.a**  
**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllt më 31 dhjetor 2021**  
*(Vlerat në Lek, përvogë nëse shprehet ndryshe)*

**5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)**

**Dëmet**

Historiku i dëmeve te paguara bruto nga Shoqëria përsa i përket kohës së pagesës së dëmeve është si më poshtë.

Ne mijë lekë	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Totali
Ne fund le vizit te akësidentit	48,526,166	78,899,578	39,975,187	59,432,641	137,999,084	213,929,548	428,577,564	555,386,796	330,958,632	514,246,503	2,407,931,699
1 vit me vone	45,409,411	30,505,319	83,663,855	60,887,247	79,373,508	144,533,877	144,108,090	1,227,888,036	108,719,500		1,925,088,843
2 vite me vone	17,576,199	28,052,069	30,043,738	26,583,250	40,538,398	23,340,957	35,775,901	199,359,771			401,270,283
3 vite me vone	13,239,026	14,939,623	17,177,649	10,492,796	15,443,250	10,475,429	8,419,231				90,187,004
4 vite me vone	9,432,116	7,842,481	23,472,085	3,555,814	99,947,805	4,348,114					148,598,415
5 vite me vone	6,025,830	55,407	1,124,514		313,614						7,519,365
6 vite me vone	6,115,461		5,069,061								11,184,522
7 vite me vone	484,215		351,858								836,073
8 vite me vone	1,029,274										1,029,274
9 vite me vone	26,507										26,507
<b>Kumulative</b>	<b>147,864,205</b>	<b>160,646,335</b>	<b>200,526,089</b>	<b>160,951,748</b>	<b>373,615,659</b>	<b>396,627,925</b>	<b>616,880,786</b>	<b>1,982,634,603</b>	<b>439,678,132</b>	<b>514,246,503</b>	<b>4,993,671,985</b>

Shpenzimet për trajtimin e dëmeve gjatë vitit 2021 janë në vlerën 33,565,311 lekë (2020: 35,040,539 lekë lekë).

**b. Reziku i normës së interesit**

Reziku i normave të interesit është i ndikuar nga rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të lidhura me interesat e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilët është fiksuar norma e interesit mbi një instrument finansiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesit të tregut.

## 5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)

### c. Rreziku i kredisë

Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe rreziku i shkaktimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interes fikse.

Rreziku i kreditit i referohet rrezikut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primet fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme nga ku risiguruesit mund të kenë klasifikime BB ose norma më të larta dhe rreziku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave

<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>A+</b>	<b>A</b>	<b>A-</b>	<b>AA</b>	<b>AA-</b>	<b>AA+</b>	<b>BB</b>	<b>Pa normë</b>	<b>Totali</b>
në '000 Lekë									

#### Aktivet Financiare

Investimet	-	-	-	-	-	-	-	1,409,925	1,409,925
Aktive të lidhura me risigurimin	1,368	10,531	8,301	1,570	72,217	1,447	-	7,642	103,076
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-	-	-	100,325	100,325
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	-	112,167	112,167
Mjete monetare në arkë dhe bankë	-	-	-	-	-	-	-	68,691	68,691

<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>A+</b>	<b>A</b>	<b>A-</b>	<b>AA</b>	<b>AA-</b>	<b>AA+</b>	<b>BB</b>	<b>Pa normë</b>	<b>Totali</b>
në '000 Lekë									

#### Aktivet Financiare

Investimet	-	-	-	-	-	-	-	1,287,370	1,287,370
Aktive të lidhura me risigurimin	13,936	41,908	68,367	404	214,132	574	-	3,884	343,205
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-	-	-	108,691	108,691
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	-	72,744	72,744
Mjete monetare në arkë dhe bankë	-	-	-	-	-	-	-	60,642	60,642

**Albsig sh.a**

**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllt më 31 dhjetor 2021**

(Vlerat në Lek, përvèç nëse shprehët ndryshe)

**5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)**

**c. Rreziku i kredisë (vazhdim)**

Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit janë si më poshtë:

	2021				2020			
	Aktivete		risigurimit		Aktivete		risigurimit	
	Primet e ceduara ‘000 Lek	% ndaj totalit	risigurimit ‘000Lek	% ndaj totalit	Primet e ceduara ‘000 Lek	% ndaj totalit	‘000 Lek	% ndaj totalit
<b>Norma</b>								
AA	5,909	3.9%	1,570	4.0%	70	0,1%	404	1,6%
A+	7,986	5.2%	190	0.5%	11,825	9,5%	205	0,8%
A	33,625	22.0%	9,806	25.2%	23,516	18,8%	6,291	25,7%
A-	12,873	8.4%	1,795	4.6%	18,100	14,5%	3,308	13,5%
AA-	71,855	47.1%	16,466	42.3%	57,320	45,9%	9,802	40,1%
AA+	6,714	4.4%	1,447	3.7%	2,215	1,8%	574	2,3%
AAA	1,478	1.0%	-	0.0%	1,336	1,1%	-	0,0%
Pa norme	12,068	7.9%	7,642	19.6%	10,609	8,5%	3,884	15,9%
<b>Totali</b>	<b>152,508</b>	<b>100,0%</b>	<b>38,916</b>	<b>100,0%</b>	<b>124,991</b>	<b>100,0%</b>	<b>24,468</b>	<b>100,0%</b>

Tabela më poshtë jep informacion në lidhje vlerat e bruto të aktiveve që janë brenda afatit, të pa zhvlerësuara, jetëgjatësinë e aktiveve që i ka tejkaluar afati por nuk janë zhvlerësuar dhe aktivet që janë zhvlerësuar.

31 dhjetor 2021	Brenda afatit, të pa zhvlerësuara	Deri në 3-muaj të tejkaluara	Mbi 3 muaj të tejkaluara	Të zhvlerësuara	Totali
Rezerva risigurimit	103,076,076	-	-	-	103,076,076
Të arkëtueshme nga aktiviteti sigurues	6,752,352	208,962,364	55,184,896	-	270,899,612
Të arkëtueshme nga aktiviteti agjent	5,572,047	-	-	-	5,572,047
Të arkëtueshme nga palet e lidhura	50,689,493	-	-	-	50,689,493
Të arkëtueshme nga aksionarët	-	30,727,654	-	-	30,727,654
<b>Eksposimi total i rrezikut të kredisë</b>	<b>166,089,968</b>	<b>239,690,018</b>	<b>55,184,896</b>	<b>-</b>	<b>460,964,882</b>

31 dhjetor 2020	Brenda afatit, të pa zhvlerësuara	Deri në 3-muaj të tejkaluara	Mbi 3 muaj të tejkaluara	Të zhvlerësuara	Totali
Rezerva risigurimit	343,203,122	-	-	-	343,203,122
Të arkëtueshme nga aktiviteti sigurues	6,909,490	219,526,969	56,469,136	-	282,905,595
Të arkëtueshme nga aktiviteti agjent	9,265,416	-	-	-	9,265,416
Të arkëtueshme nga palet e lidhura	60,521,931	-	-	-	60,521,931
Të arketueshme nga aksioneret	-	48,168,963	-	-	48,168,963
<b>Eksposimi total i rrezikut të kredisë</b>	<b>419,899,959</b>	<b>267,695,932</b>	<b>56,469,136</b>	<b>-</b>	<b>744,065,027</b>

**5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)****d. Rreziku i risigurimit**

Shoqerise perjate aktivitetit te saj i shkaktohen rreziqe te sigurimit brenda limiteve te ekspozimit te humbjeve te nënshkruara nën marrëveshje të ndryshme që mbulojnë linja biznesi te përcaktuara, mbi bashkësigurimin, çdo vit me terma te rinovueshëm dhe tejkalim i bazave te humbjes. Këto marrëveshje risigurimi shpërndajnë rezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Sipas termave te marrëveshjes se risigurimit, risiguruesi bie dakord te rimburojë shumën e ceduar në ngjarjen kur paguhet dëmi. Gjithsesi shoqëria mbetet përgjegjëse ndaj policëmbajtësve te saj duke respektuar sigurimin e ceduar nëse ndonjë risigurues dështon te plotësojë detyrimet që merr përsipër.

Kur përzgjidhet një risigurues shoqëria merr në konsideratë sigurinë e tyre relative. Siguria e risiguruesit eshtë vlerësuar nga informacioni i normimit publik.

**e. Rreziku i administrimit te kapitalit**

Strategjia e shoqërisë në lidhje me rrezikun e kapitalit nuk ka ndryshuar. Struktura kapitale e shoqërisë konsiston në kapitalin aksionar të shoqërisë që përbëhet nga kapitali themeltar, rezervat dhe fitimet e mbartura. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar nivelin e duhur të kapitalit në mënyrë që të jetë e aftë të vazhdojë në vijimësi dhe të përmbushë me kërkesat rregullatore të kapitalit, ndërkohë që maksimizon kthimin tek aksionaret nëpërmjet optimizmit të gjendjes se detyrimeve dhe kapitalit.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 aksionet e kapitalit të Shoqërisë janë në përputhje me kërkesat dhe rregullat për sigurimet, për kapitalin aksionar.

**f. Rreziqe të tjera**

Ndryshimet legjislativë në segmentet e biznesit në të cilat operon shoqëria mund të ndikojnë tek fitimet Aktiviteti i sigurimeve eshtë objekt i mbikëqyrjeve gjithëpërfshirëse e në zhvillim e sipër në Shqipëri. Qëllimi kryesor i legjislativit eshtë mbrojtja e të siguruarve. Ndryshime të ligjeve mbi sigurimet mund të ndikojnë mbi aktivitetin e shoqërisë dhe të produkteve të ofruara. Ligjet mbi sigurimet dhe rregulloret e ndryshuara në kohë mund të jenë kufizuese dhe me kosto më të larta.

**g. Rreziku nga kurset e këmbimit**

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEK, USD dhe EURO). Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

		<b>2021</b>	<b>2020</b>
	<b>Ndikimi</b>	<b>në Lek</b>	<b>në Lek</b>
EUR rritet me 5% ndaj Lekut	Fitim	(11,539,049)	(19,643,824)
EUR ulet me 5% ndaj Lekut	Humbje	11,539,049	19,643,824
USD rritet me 5% ndaj Lekut	Fitim	7,320,421	6,513,238
USD ulet me 5% ndaj Lekut	Humbje	(7,320,421)	(6,513,238)

Absig sh.a  
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllt më 31 dhjetor 2021  
(Vlerat në Lek, përvet nëse shprehët ndryshe)

**5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)**

**g. Reziku nga kurset e këmbimit (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rezikut valutor të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

**31 dhjetor 2021**

	<b>Leke</b>	<b>Euro</b>	<b>USD</b>	<b>GBP</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktive financiare</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to Investime	25,319,029 865,618,459	37,304,093 429,339,423	6,068,294 114,966,902	-	68,691,416 1,409,924,784
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit Aktive të lidhura me risigurimin	276,570,347	(98,688) 103,076,076	-	-	276,471,659 103,076,076
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura Aktive të tjera	57,708,780 94,704,345	11,888,480 14,479,813	30,727,654 2,983,136	-	100,324,914 112,167,294
Tatim fitim i arketueshem Kosto të shiyra të marries në sigurim Aksione në shoqëri të lidhura	- 814,547,024 432,254,000	-	-	-	814,547,024 432,254,000
<b>Totali aktiveve financiare</b>	<b>2,566,721,984</b>	<b>595,989,197</b>	<b>154,745,986</b>	<b>-</b>	<b>3,317,457,167</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Reserva teknike per demet Rezervat e primit te paftuar Llogari te pagueshme per risigurimet Detyrime ndaj paleve te lidhura Tatim fitimi i pagueshem Detyrime te tjera	(636,586,212) (1,421,156,133)	(96,793,176) (659,175,441)	(8,337,564) (35,474,884)	- (4,468,120)	- (35,474,884) (19,957,356) (8,391,046) (251,067,910)
Totali detyrimeve financiare Pozicioni valutor, neto	(2,301,831,975) <b>264,890,009</b>	(826,770,183) <b>(230,780,986)</b>	(8,337,564) <b>146,408,422</b>	-	(3,136,939,722) <b>180,517,445</b>

**Absig sh.a**  
**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllt më 31 dhjetor 2021**  
*(Vlerat në Lek, përvèç nëse shprehet ndryshe)*

**5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)**

**g. Reziku nga kurset e këmbimit (vazhdim)**

**31 dhjetor 2020**

	Leke	Euro	USD	GBP	Totali
<b>Aktive financiare</b>					
Mijete monetare dhe ekuivalentë me to	28,912,534	27,849,096	3,877,122	3,302	60,642,054
Investime	828,386,701	349,985,341	108,997,463	-	1,287,369,505
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	157,375,616	133,820,180	975,215	-	292,171,011
Aktive të lidhura me risigurimin	-	343,203,122	-	-	343,203,122
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	58,757,411	33,518,516	16,414,967	-	108,690,894
Aktive të tjera	64,416,681	8,327,759	-	-	72,744,440
Tatim fitimi i arkëtueshem	4,983,869	-	-	-	4,983,869
Kosto të shtyra të marjes në sigurim	523,840,981	-	-	-	523,840,981
Aksione në shoqëri të lidhura	432,254,000	-	-	-	432,254,000
<b>Totali aktiveve financiare</b>	<b>2,098,927,793</b>	<b>896,704,014</b>	<b>130,264,767</b>	<b>3,302</b>	<b>3,125,899,876</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Rezerva teknike per demet	(338,285,700)	(688,530,131)	-	-	(1,026,815,831)
Rezervat e primit te paftuar	(1,039,410,582)	(462,512,863)	-	-	(1,501,923,445)
Llogari te pagueshme per risigurimet	-	(34,497,258)	-	-	(34,497,258)
Detyrime ndaj paleve te lidhura	(3,282,329)	(32,247,267)	-	-	(35,529,596)
Tatim fitim i pagueshmen	-	-	-	-	-
Detyrime te tjera	(209,573,082)	(71,792,974)	-	-	(281,366,056)
<b>Totali detyrimeve financiare</b>	<b>(1,590,551,693)</b>	<b>(1,289,580,493)</b>	<b>130,264,767</b>	<b>3,302</b>	<b>(2,880,132,186)</b>
<b>Pozicioni valutor, neto</b>	<b>508,376,100</b>	<b>(392,876,479)</b>			<b>245,767,690</b>

**Absig sh.a**  
**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllt më 31 dhjetor 2021**  
*(Vlerat në Lek, përvç nëse shprehet ndryshe)*

**5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)**  
**gj:** Reziku i likuiditetit

Tabela më poshtë analizon aktivet dhe pasivet financiare të shoqerisë me 31 dhjetor 2021 dhe 2020 në grupe të ngjashme maturiteti duke u bazuar në kohën e mbetur nga data e raportimit në maturitetin aktual:

	<b>Me pak se 3 muaj</b>	<b>3 - 12 muaj</b>	<b>1 - 5 vjet</b>	<b>Mbi 5 vjet</b>	<b>Total</b>
<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>68,691,416</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>68,691,416</b>
<b>Aktive financiare</b>					
Mjetë monetare dhe ekuivalentë me to investime	-	380,717,824	1,029,206,960	-	1,409,924,784
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	218,151,680	57,518,101	801,878	-	276,471,659
Aktive të lidhura me risigurimin	103,076,076	-	-	-	103,076,076
Llogari të arkëtueshme nga palet e lidhura	31,310,612	69,014,302	-	-	100,324,914
Aktive të tjera	38,348,533	73,818,761	-	-	112,167,294
Tatim fitim i arketueshem	-	-	-	-	-
Kosto të shtyra të marjes në sigurim	58,752,594	494,240,298	57,470,902	204,083,231	814,547,025
Aksione në shoqëri të lidhura	-	-	-	432,254,000	432,254,000
<b>Totali aktiveve financiare</b>	<b>518,330,911</b>	<b>1,075,309,286</b>	<b>1,087,479,740</b>	<b>636,337,231</b>	<b>3,317,457,168</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Rezerva teknike per demet	178,780,372	425,015,995	110,006,908	19,576,113	733,379,388
Rezervat e primit te paftuar	22,443,481	1,267,335,621	147,367,426	651,522,611	2,088,669,138
Llogari te pagueshme per risigurimet	-	35,474,884	-	-	35,474,884
Detyrime ndaj paleve te lidhura	-	19,957,356	-	-	19,957,356
Tatim fitimi i pagueshem	8,391,046	-	-	-	8,391,046
Detyrime te tjera	56,278,591	158,800,635	35,988,684	-	251,067,910
<b>Totali detyrimeve financiare</b>	<b>265,893,490</b>	<b>1,906,584,491</b>	<b>293,363,018</b>	<b>671,098,724</b>	<b>3,136,939,722</b>
<b>Pozicioni neto</b>					
<b>Pozicioni kumulativ</b>	<b>252,437,421</b>	<b>(831,275,205)</b>	<b>794,116,722</b>	<b>(34,761,493)</b>	<b>180,517,446</b>
	<b>252,437,421</b>	<b>(578,837,784)</b>	<b>215,278,939</b>	<b>180,517,446</b>	

**Absig sh.a**  
**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllt më 31 dhjetor 2021**  
*(Vlerat në Lek, përvç nëse shprehet ndryshe)*

**5. Aktivitët rreziqeve (vazhdim)**  
**gj. Reziku i likuiditetit (vazhdim)**

	<b>Me pak se 3 muaj</b>	<b>3 - 12 muaj</b>	<b>1 - 5 vjet</b>	<b>Mbi 5 vjet</b>	<b>Total</b>
<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>60,642,054</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>60,642,054</b>
<b>Aktive financiare</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to investime	-	1,041,219,005	246,150,500	-	1,287,369,505
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	235,701,875	55,622,229	846,907	-	292,171,011
Aktive të lidhura me risigurimin	343,203,122	-	-	-	343,203,122
Llogari të arkëtueshme nga palet e lidhura	33,652,305	75,038,589	-	-	108,690,894
Aktive të tjera	24,869,791	47,874,649	-	-	72,744,440
Kosto të shpyra të marries në sigurim	4,983,869	-	-	-	4,983,869
Aksione në shoqëri të lidhura	52,576,870	362,296,538	19,068,239	89,899,334	523,840,981
Totali aktiveve financiare	-	-	-	432,254,000	432,254,000
<b>Detyrime financiare</b>					
Rezerva teknike per demet	<b>755,629,886</b>	<b>1,582,051,010</b>	<b>266,065,646</b>	<b>522,153,334</b>	<b>3,125,899,876</b>
Rezervat e primit te pafiuar	325,450,500	484,770,861	161,850,432	54,744,038	1,026,815,831
Llogari te pagueshme per risigurimet	150,745,050	1,038,753,521	54,671,238	257,753,636	1,501,923,445
Detyrime ndaj paleve te lidhura	-	34,497,258	-	-	34,497,258
Tatim fitimi i pagueshem	-	35,529,596	-	-	35,529,596
Detyrime te tjera	63,070,127	177,964,235	40,331,694	-	281,366,056
<b>Totali detyrimeve financiare</b>	<b>539,265,677</b>	<b>1,771,515,471</b>	<b>256,853,364</b>	<b>312,497,674</b>	<b>2,880,132,186</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>216,364,209</b>	<b>(189,464,461)</b>	<b>9,212,282</b>	<b>209,655,660</b>	<b>245,767,690</b>
<b>Pozicioni kumulativ</b>	<b>216,364,209</b>	<b>26,899,748</b>	<b>36,112,030</b>	<b>245,767,690</b>	

**Albsig sh.a**

**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllt më 31 dhjetor**

**2021**

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehët ndryshe)

## **6. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to**

Mjete monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Para në bankë dhe në monedhë të huaj	41,087,320	28,271,986
Para në bankë dhe Lek	24,095,701	26,123,334
Para në arkë	3,508,395	6,246,734
	<b>68,691,416</b>	<b>60,642,054</b>

Paraja në bankë përfshin llogari rrjedhëse. Mjetet monetare dhe ekuivalentet sipas monedhës origjinale janë detajuar si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Leke	25,319,029	28,912,534
Euro	37,304,093	27,849,096
USD	6,068,294	3,877,122
GBP	-	3,302
	<b>68,691,416</b>	<b>60,642,054</b>

## **7. Investime**

Investimet me bankat dhe intitucionet financiare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë të detajuara si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Depozita Bankare	923,446,018	751,211,997
Fond Garancie	374,347,031	458,983,120
Interes i përllogaritur	12,131,735	10,174,388
Investime tek Albsig Invest sha	100,000,000	67,000,000
	<b>1,409,924,784</b>	<b>1,287,369,505</b>

Fondi i garancisë përbëhet nga depozitat bankare të bllokuara pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është disponibël për operacione të përditshme.

Depozitat me bankat përfshijnë depozita bankare të tjera me maturitet më shumë se 12 muaj.

Në përputhje me Nenin 81 të Ligji nr. 52. datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". fondi i garancisë nuk duhet të jetë më pak se 1/3 e kufirit minimal të aftësisë paguese por jo më pak se 370 milion Lek. në bono thesari dhe depozita me afat me maturimi jo më të vogël se 1 vit.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020. fondi i garancie së Shoqërisë është mbi nivelin minimal të kërkuar sipas rregulatorit.

## 7. Investime (vazhdim)

Depozitat me bankat dhe fondet e garancisë janë detajuar në monedhat si më poshtë:

	<u>interes %</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>interes %</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Në EURO	0,01 - 0,80	429,339,423	0,01 - 0,80	349,985,703
Në LEK	0,10 - 2,20	753,281,989	0,10 - 3,50	751,211,997
Në USD	0,30 - 0,90	115,171,637	0,30 - 1,00	108,997,417
		<b>1,297,793,049</b>		

Detajimi i depozitave me afat sipas bankave dhe institucioneve financiare është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Banka Intesa San Paolo	179,620,693	410,697,066
Union Bank	244,077,400	245,150,500
Banka Amerikane e Investimeve	132,076,000	132,370,000
Banka e Tiranës	338,047,800	120,988,500
Banka Credins	108,429,901	99,016,221
Banka e Bashkuar e Shqipërisë	10,000,000	73,000,000
ProCredit Bank	90,654,000	60,084,000
Banka OTP	12,500,000	43,425,000
Raiffeisen Bank	18,111,800	17,142,800
Banka e Parë e Investimeve	5,210,818	5,205,613
Banka Kombëtare Tregtare	159,064,637	3,115,417
Interes i përllogaritur	12,131,735	10,174,388
Investime tek Albsig Invest sha	100,000,000	67,000,000
		<b>1,409,924,784</b>
		<b>1,287,369,505</b>

## 8. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit

Llogarite e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Të arkëtueshme nga klientët, neto	251,445,066	282,905,595
Të arkëtueshme nga agjentët, neto	5,572,047	9,265,416
Të arkëtueshme nga shoqëritë e sigurimeve, neto	19,454,546	-
		<b>276,471,659</b>
		<b>292,171,011</b>

Detyrimet nga klientët neto më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime nga klientët, bruto	327,047,105	348,202,944
Minus zhvleresimi i akumuluar	(75,602,039)	(65,297,349)
<b>Detyrime nga klientët, neto</b>	<b>251,445,066</b>	<b>282,905,595</b>

**Albsig sh.a**

**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllt më 31 dhjetor**

**2021**

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehë ndryshe)

**8. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit (vazhdim)**

Lëvizjet në zhvlerësimin e llogarive të sigurimit të arkëtueshme nga klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Shuma në fillim të vitit	(65,297,349)	(54,690,539)
Shtesa në zhvlerësim gjatë periudhës	(10,304,690)	(10,606,810)
<b>Balance në fund të vitit</b>	<b>(75,602,039)</b>	<b>(65,297,349)</b>

Vjetërsia e llogarive të sigurimit të arkëtueshme nga klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Me pak se 3 muaj	217,954,177	226,926,461
3 – 12 muaj	33,177,411	55,132,227
Mbi 1 vit	313,478	846,907
<b>Te arketueshme nga klientët. neto</b>	<b>251,445,066</b>	<b>282,905,595</b>

**9. Aktive të lidhura me risigurimin**

Rezerva e risigurimit më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhet si më poshtë:

